

AKT THEMELIMI

PER SHOQERINE TREGTARE "BEQIRI" SHPK B A L L S H

Ne, Ballsh, sot me date 24.10.1999, une Neim Beqiri, i biri Taullait dhe Selvise, i datelindjedjes 25.9.1957, banues ne Ballsh, mbeshtetur ne ligjin 7632 date 4.11.1992 dhe ligjin 7638 date 19.11.1992, beje kete akt themelimi:

Neni 1

Themeloj shoqerine trgtare, te llojit me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "Beqiri" sh p k.

Neni 2

Kjo shoqeri tregtare ka statusin e personit juridik shqiptar.

Neni 3

Selia dhe qendra e saj jane ne lagjen "28 nentori" Ballsh.

Neni 4

Krijohet me mjetet financiare te ortakut te vetem, Neim Beqiri, qe si fillim kap shifren prej 100000 (njqindmije) leke.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare "Beqiri" shpk eshte:  
- Projektme dhe zbatime ne fushen e ndertimit, godina e objekte civile e sociale, rruge-ura, vepra hidroteknike, konstruksione betoni e metalike etj te kesaj natyre.

- Prodhim materialesh inerte, tulla, blloqe, gelqere, çakkell, gure e fraksione te tij, tregtim te tyre.

- Tregtim materiale, pajisje dhe makineri ndertimi, import-export.

Neni 6

Organi i vetem drejtues i shoqerise tregtare eshte ortakut i vetem Neim Beqiri, qe njekohesisht eshte administrator i shpk "Beqiri" Ballsh.

Neni 7

Veprimtaria e saj zgjat permby 10 vjet kohe.

Neni 8

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i shoqerise tregtare eshte ne favor te ortakut te vetem Neim Beqiri, ne masen 100 perqind.

Neni 9

Per detyrimet ndaj personave te trete juridike apo fizike, shoqeria tregtare "Beqiri" shpk pergjigjet me mjetet e veta materiale e financiare

Neni 10

Rreziku i humbjeve rendon mbi ortakun e vetem Neim Beqiri.

Neni 11

Per funksionimin normal te shoqerise tregtare, ortakut i vetem harton statutin e saj, ku parashikohet detajet per aktivitetin.



- 2 -

Neni 12

Veprimtaria e hoqerise tregtare "Beqiri" shpk Ballsh, ushtrohet ne gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jahste vendit, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 13

Per te drejtuar veprimtarine e shoqerise tregtare ne fushen e nderimit, drejtuese teknike eshte inxh. Ludmilla Zeka, e licensuar posaçrisht.

Neni 14

SHPK "Beqiri" Ballsh shperbehet ne rastet e parashikuara ne ligjin shqiptar si dhe statutin e saj.

Neni 15

Shoqeria tregtare "Beqiri" shpk Ballsh fiton personalitet juridik me berjen e rregjistrimit ne rregjistrim tregtar prane Gjykates se shkalles se pare te rrethit gjyqesor Tirane.

Prane asaj gjykate depozitohen nje kopje akt themelimit, nje kopje e statutit dhe kerkesa perkatese.

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE "BEQIRI" SHPK

NEIM BEQIRI

*Neim Beqiri*

*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA E RRETHIT

Nr. 3477/17

26/10 1999

V E R T E T I M

Sot, me date 26/10 1999 perpara meje noterit u paraqit z. Neim Beqiri, i biri Taullait dhe Selvise, i vitlindjes 1957, lindur ne Kalenje dhe banues ne lagjen "28 nentori" Ballsh, me zotesi te plote juridike per te vepruar, njohur me dokumentin personal

Ai deklaroi se kete akt e ka bere vete dhe nenshkruan me vullnet te lire ne pranine time, une noteri e vertetoj rregullisht sipas ligjit.



NOTERI

~~NOTER~~

Minella Milo

*[Signature]*

